



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 02 / 1591 **Dt.** 31 / 07 /2024

Në mbështetje të nenit 22, paragrafi 1, pika 2, të Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues të UKZ-së, nr.02/2900 të datës 19.12.2023, Këshilli Drejtues në mbledhjen e tridhjetë e shtatë (XXXVII) të mbajtur më datë 29.07.2024, mori:

V E N D I M

1. z. Isa Keka zgjidhet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.
2. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm është për një periudhë 4 vjeçare me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm janë të përcaktuara në nenin 41 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e tridhjetë e shtatë të mbajtur më datë 29.07.2024, shqyrtoi raportin e punës për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të përgatitur nga Zyra e Personelit Ref. Nr. 05/1554 të datës 26.07.2024, sipas cilit raport kandidati më i suksesshëm ka qenë z. Isa Keka.

Andaj, duke u bazuar në nenin 39 të Statutit të UKZ, Rektori i Universitetit bazuar në raportin e Komisionit Profesional i propozon Këshillit Drejtues që kandidati z. Isa Keka të zgjidhet Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit.

Këshilli Drejtues miratoi propozimin e Rektorit për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të UKZ-së.



Kryesuese e KD-së

Ph.D.cand. Arta Istrefi Jahja

Vendimi t'i dërgohet:

1. Rektorit të UKZ-së;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Zyrës së Financave;
4. Zyrës së Personelit;